



## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Regjistrimi i Partisë: *Partia e Pensionistëve të Kosovës* - PPK, i hapur për shqyrtim publik

**Prishtinë, 21 dhjetor 2009** – “Partia e Pensionistëve të Kosovës” (PPK) sot ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës 7 (shtatë) ditore, gjatë të cilës publiku mund të shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“PPK” është themeluar më 10 dhjetor 2009 nga z. Sahit Dragaj dhe sipas programit të saj angazhohet për organizim efikas të shtetit juridik dhe respektimin e gjitha parimeve demokratike. Sipas këtij programi, përpiqet të jetë iniciator dhe garant i mëkëmbjes së ekonomisë nacionale, ku një prej prioriteteve të zhvillimit ekonomik do të jetë rikonstruktimi i shpejtë dhe privatizimi. Kujdes të veçantë do të kushtojë politikës sociale, sigurimit pensional dhe invalidor dhe mbrojtjes së plotë adekuate shëndetësore të qytetarëve. Angazhohet për sistem modern të shkollimit, si dhe shkollim pa pagesë, për ruajtjen e vlerave kulturore dhe të artit të Kosovës, për sistem të mbrojtjes që do të jetë garant i sigurisë personale dhe materiale të çdo qytetari. Kjo iniciativë politike do të angazhohet për mbrojtje të mjedisit, transparencë në punë si dhe bashkëpunim me partitë tjera.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë” *Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës.*

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe simbolin do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparencës për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 21 dhjetor deri më 27 dhjetor 2009.

Për informatë shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 20023006.